



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

---

Numri i lëndës:	2024:252298
	KA.nr.459/24
Datë:	09.10.2024
Numri i dokumentit:	06285231

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Albimi” LTD SH.P.K me seli në Gjilan, me përfaqësues sipas autorizimit Av. Iliriana Osmani Serreqi, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit nr. 31-24/Ref: 0047110/24 të datës 06.06.2024, jashtë seancës, me datë 09.10.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSTATOHET** e tërhequr padia e paditësit “Albimi” LTD SH.P.K me seli në Gjilan, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me seli në Prishtinë, dhe **PEZULLOHET** procedura për të vendosur lidhur me kërkesë padinë për anulim të Vendimit nr. 31-24/Ref: 0047110/24 të datës 06.06.2024.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Paditësi “Albimi” LTD SH.P.K me seli në Gjilan me datën 16.09.2024 ka parashtruar padi, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit nr. 31-24/Ref: 0047110/24 të datës 06.06.2024.

Paditësi me datë 04.10.2024 në Gjykatë ka dorëzuar parashtrësë për tërheqjen e padisë, duke i propozuar gjykatës që të nxjerr aktvendim me të cilin e konstaton si të tërhequr padinë e paditësit.

Gjykata konstaton se përfaqësuesi i paditësit me autorizim të datës 02.07.2024 është autorizuar që të i ndërmerr të gjitha veprimet procedurale në emër të paditësit përfshirë edhe heqjen dorë nga padia.

Prandaj, konform Ligjit nr. 03/1-202 për Konfliktet Administrative, Neni 31 paragrafi 1. ku përcaktohet *Paditësi mund të heqë dorë nga padia derisa të mos merret vendimi. Në këtë rast gjykata e pezullon procedurën me vendim*, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm

KA.nr.459/24, me datë 09.10.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.